



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr.584/13

GJYKATA THEMELORE në Prizren, me gjyqtaren Shpresa, Emra, në qështjen juridike të paditëses Xh. H. nga Prizreni, të cilën e përfaqëson i autorizuari B. L. nga Prizreni, kundër të paditurës Drejtoria për Arsim e Komunës së Prizrenit të cilën e përfaqëson Avokati Publik Besim Morina nga Prizreni, pagesën e shpërblimit jubilar, në shqyrtim të mbajtur me dt. 26.02.2014 mori këtë,

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZHET** kërkespadija e paditëses Xh. H. nga Prizreni, me të cilën është kërkuar që të obligohet e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria për Arsim, që paditëses ti paguaj në emër të shpërblimit jubilar me rastin e daljes në pension shumën prej 1.384,16€ me kamatë ligjore dhe shpenzimet procedurale në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm – **SI E PABAZUAR**.
- II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

Arsyetim

Pretendimet e palëve

Paditësja nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar padi për kompensim dhe pagesë të shpërblimit jubilar nga ana e të paditurit duke cekur se ka qenë në marrëdhënje pune në SHFMU“E: D. “ në Prizren dhe sipas Aktvendimit të Drejtoriatit për Arsim të Prizrenit me dt. 16.03.2011 i ndërprehet marrëdhënja e punës pasi që i ka plotësuar kushtet ligjore për pensionim dhe ka arritur moshën e shtatëdhjetë vjeçare. Në bazë të vërtetimit të dhënë nga



ana e SHFMU "E. D. ..." në Prizren paditësja ka 46 vjet përvojë të punës dhe paga mesatare për tre muaj para pensionimit ka qenë $346,08 \times 2 = 692,08\text{€}$ dhe dy pagat e shpërblimit jubilar duhet të jenë 1.384,16€. E paditura nuk i ka respektuar detyrimet e veta të cilat rrjedhin nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive e nënshkruar nga ana e Qeverisë së republikës së Kosovës dhe Odës ekonomike e cila në dispozitën e nenit 43 dhe 44 parasheh që punëtorit me rastin e pensionimit i takojnë dy paga në lartësi mesatare në tre muaj të fundit në emër të shpërblimit jubilar, paditësja është drejtuar gjyktës dhe ka kërkuar që gjykata ta obligojë të paditurën të përmbyshtë obligimin e saj dhe të paguaj shumën prej 1.384,16€ në emër të shpërblimit jubilar. Në fjalën e tij të fundit I autorizuari I paditëses ka deklaruar se ngel në tërësi pranë kërkesëpadisë dhe ka propozuar që gjykata ta aprovojë të njëjtën në tërësi sit ë bazuar. I ka kërkuar shpenzimet procedural për dy séance sipas tarifës së avokatëve me nga 121€, për përpilim të padisë dhe shpenzimet për taksën në padi dhe aktgjykim të gjykatës.

I autorizuari i të paditurit nuk ka dhënë përgjigje në padi , por në shqyrtimin kryesor e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën nga padia në tërësi si të pabazuar duke cekur se paditësja thirret në kontratën kolektive e cila nuk ka gjetur implementim në praktikën e Kosovës dhe nëse eventualisht e njëjta ka pasur efekte të saja kjo ka ndodhur në vitin 2005 gjer më vitin 2008 sa është menduar se e njëjta ka validitet . Paditësja da shkuar në pension në vitin 2011 dhe e paditura nuk konsideron se ka borxh ndaj të njëjtës andaj propozon që gjykata ta refuzojë sit ë pabazuar bazuar në praktikën e gjerëtanishme të gjykatave më të larta dhe ligjit. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.


Vlerësimi i provave

Në procedurë të provave gjykata I administroj këto prova: bëri leximin e vendimit mbi shuarjen e marëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension të punëtores Xh. H. nga Prizreni, Ref.nr.258/11, të dt.16.03.2011, dhe lexoi vërtetimin e lëshuar nga ana e Shkollës fillore "E. D. ..." në Prizren.

Gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe në kuptim të nenit 8 të LPC, dhe ka gjetur se **kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar.**

Me leximin e vendimit mbi shuarjen e marëdhënies së punës të punëtores Xh. H. nga Prizreni, gjykata vërtetoi se e njëjta është caktuar në punë dhe detyrat e punës si mësimdhënëse e lëndës së edukates muzikore në SHFMU "E. D. ..." në Prizren dhe e lartpërmendura I plotëson kushtet ligjore për pensionim gjegjësisht mbush moshën 65 vjeqare dhe me këtë me dt.13.04.2011, I ndërpret marëdhënia e punës. Vendimi është lëshuar nga ana e Drejtorisë së Arsimit në Prizren drejtori Nexhat Çoçaj.

Nga vërtetimi I lëshuar nga ana e SHFMU "E. D. ..." nga Prizreni, gjykata vërtetoi se Xh. H. ka punuar 46 vite në këtë shkollë si arsimtare e muzikës dhe paga e fundit mujore para pensionimit ka qenë 346.08 euro. Vërtetimi është nënshkruar nga ana e Drejtorit.




Gjykata në rastin konkret pas administrimit të provave vërtetoi se nuk është kontestuese se paditësja ka punuar në Shkollën fillore si arsimtare e muzikës dhe me arritjen e moshës 65 vjeçare bazuar në ligj është pensionuar me vendim të paditurit. Kërkesa e paditësës ka qenë që të zbatohet neni 44 i Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës e vitit 2005 e cila parasheh që punëtorit i cili del në pension i takon shpërblimi jubilar për dy paga mesatare të cilat i ka pranuar si page të fundit. Kontrata e Përgjithshme Kolektive në rastin konkret nuk mund të zbatohet pasi që nuk është nënshkruar në tërësi nga Këshilli Konsultativ trepalësh dhe në fuqi është vetëm neni 23 që ka të bëjë me pushimin e lehonisë. Gjithashtu kontrata kolektive është nënshkruar në vitin 2005 dhe ka pasur afat gjer më vitin 2008 ku më pas është dashur që të shëndrrohet në ligj dhe të rregullohen edhe çështjet tjera, në mes tjerash edhe çështja e pagesës jubilarë dhe e pensionimit. Kjo nuk është arritur andaj duke pasur parasysh që paditësja është pensionuar në vitin 2011, gjykata konsideron se kërkesa e saj për pagesë të shpërblimit jubilar nuk mund të aprovet si e bazuar pasi që nuk ka mbështetje ligjore.

Shpenzimet e procedurës janë caktuar në bazë të nenit 452.1 LPK pasi që pala e cila humb kontestin i paguan shpenzimet palës e cila fiton kontestin, gjykata ka aprovuar kërkesën për kompensim të shpenzimeve sipas tarifës së avokatëve.

Bazuar në të gjitha të lartëcekura gjykata ka vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
c.nr.584/13, me dt.26.02.2014



KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur kundër këtij aktgjykimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kopjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Gjykatës së Apelit në Prishtinë.